



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 5005 / prot. 19

Tiranë, më 21/12/2020

URDHËR

Nr. 681, datë 21.12.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 616, DATË 9.11.2020 “PËR
KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5005/18 datë 21.12.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 616, datë 9.11.2020 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e Urdhrit rifomulohet si vijon:

“Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 20:30 deri në orën 06:00 duke filluar nga datë 24.12.2020 deri në datë 04.01.2021.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, dhe fillon efektet më datë 24.12.2020. Pas datës 04.01.2021 kufizimi i lëvizjes së popullatës do të jetë në fashën orare nga ora 22:00 deri në orën 06:00 deri në një urdhër të dytë.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu

